



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJE

Nr. _____ Prot

Ersekë, më 29.02.2024

Lënda: Dërgohet Raporti i Minitorimit të Buxhetit për 12 mujorin e vitit 2023

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E BUXHETIT DHE BORXHIT PUBLIK
DREJTORIA E FINANCAVE VENDORE .

Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit",nr.3 TIRANE

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22 datë 30.07.2018 "Për Procedurat Standarte të Monitorimit të Buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore" Bashkia Kolonjë bashkalidhur po ju dërgon Raportin Për Monitorimin e Zbatimit të Buxhetit të 12mujorit të vitit 2023 me anekset përkatëse dhe relacionin shpjegues për bashkinë Kolonjë.

Ju faleminderit për bashkëpunimin ,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Sofika Rexhepi

BASHKIA KOLONJË

RAPORT PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË BUXHETIT TË DYMBËDHJETMUJORIT TË VITIT 2023

Në mbështetje të Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 48, "Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor", Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 22 date 30.07.2018 "Për procedurat Standarte të Monitorimit të Buxhetit të Njesive të Vetëqeverisjes Vendore", i paraqitëm Grupit për Menaxhim dhe Strategji në Bashki "Raportin për monitorimin e zbatimit të buxhetit të 12 mujorit të vitit 2023.

Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të Bashkisë Kolonjë për 12 mujorin e vitit 2023 është bërë në mbështetje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si më poshte:

- *Ligjin nr. 13912015 "Për veteqeverisjen vendore"*
- *Ligjin nr. 9632 date 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore ",i ndryshuar*
- *Ligjin nr. 68 /2017" Për financat e vetqeverisjes vendore"*
- *Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008" Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar.*
- *Ligjin nr 84/2022” Për buxhetin e vitit 2022".*
- *Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9 date 20.03.2018. "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit"*
- *Udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.2 dt 19.01.2023 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023".*
- *Vendimi i Këshillit të Bashkisë nr 140 datë 22.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2023".*

Raporti i monitorimit të buxhetit për periudhën janar-dhjetor 2023 paraqet punën e administratës së Bashkisë Kolonjë dhe strukturave ndihmëse në zbatimin e politikave të përcaktuara në Buxhetin afatmesëm 2021-2023 i miratuar nga Këshilli i Bashkisë si dhe buxhetin vjetor 2023 miratuar me VKB nr 147. date 22.12.2022 si në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë, ashtu edhe në menaxhimin e shpenzimeve, për një rritje të cilësive të shërbimeve të ofruara ndaj komunitetit. Zbatimi i Buxhetit të Bashkisë Kolonjë për periudhën 12-mujore është realizuar duke zbatuar me korektesi ligjet, aktet nënligjore dhe vendimet e Këshillit Bashkiak për miratimin e tij dhe ndryshimet e bëra gjatë dymbëdhjetmujorit të vitit 2023

MISIONI I BASHKISË KOLONJË

Bazuar në ligjin 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” , misioni I bashkisë është sigurimi i një qeverisje të efektshme ,efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve , nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të ndryshme , ushtrimit efektiv të funksioneve dhe kompetencave që ka bashkia duke realizuar shërbime cilësore në përputhje me kërkesat që ka komuniteti , duke pasur parasysh që buxheti është gjithpërfshirës, I paanshëm ,perceptues ,transparent , zgjidhjen dhe ofrimin

e llojeve të ndryshme të shërbimeve duke krijuar lehtësira të tjëra publike në dobi të komunitetit.

OBJEKTIVAT E BASHKISË KOLONJË PËR VITIN 2023

- ❖ Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik i qytetit Erseke , Leskovik dhe Njësave Administrative
- ❖ Zhvillimi i agro turizmit dhe i turizmit në të gjithë teritorin e bashkisë Kolonjë
- ❖ Nxitja e punësimit dhe sipërmarjes në agroturizëm
- ❖ Ofrimi i shërbimeve cilësore
- ❖ Përmirësimi i infrastrukturës rrugore rurale për të ritur përmirësimin e akseve rrugore ,duke përmirësuar shërbimet ndaj komunitetit dhe turizmit në zonat malore
- ❖ Garantimi i pastërtisë dhe reduktimi i ndotjes
- ❖ Rigjallërimi i jetës kulturore dhe sportive, në veçanti të sportit të moshave dhe ekipeve zinxhir.
- ❖ Rehabilitim i objekteve arsimore ,administrative,sociale
- ❖ Projektet strategjike

Raporti dyvjeçar i monitorimit përmban :

Aneksi nr.1 "Raporti i shpenzimeve sipas programeve";

Aneksi nr.2 "Raporti i shpenzimeve sipas artikujve

buxhetore"; Aneksi nr.3 "Raporti i realizimit te

produkteve te programit"; Aneksi nr.4 "Raporti i

realizimit te objektivave te programit"; Aneksi nr.5

"Raporti i investimeve me financim te brendshem";

"Pasqyra e treguesve financiare"

Buxheti i Bashkisë Kolonjë funksionon me 18 programe buxhetore si më poshtë:

Nr	Llogaria /programit	Emërtimi I programit buxhetor
1	01110	Planifikim ,menaxhimi dhe administrimi ,ceshtje financiare dhe fiskale
2	01170	Gjendja Civile

3	03140	Shërbimet e policis vendore dhe mardhëniet me komunitetin
4	03280	Shërbimet e mbrojtjes nga zjari
5	04130	Mbështetje për zhvillimin ekonomik QKB dhe zhvillimi I Turizmit
6	04220	Shërbimet bujqësore ,inspektimi ,ushqimi
7	04240	Menaxhimi I infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit
8	04260	Administrimi I pyjeve dhe kullotave
9	04520	Rrjeti rrugor rural
10	05100	Menaxhimi i mbetjeve dhe mbrojtja e mjedisit
11	06140	Urbanistika
12	06260	Shërbimet publike vendore dhe ndricim rrugësh
13	08130	Sporti dhe argëtimi
14	08220	Trashëgimnia kulturoe,eventet artistike
15	09120	Arsimi parashkollor
16	09230	Arsimi parauniversitar
17	10430	Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara si dhe perkujdesja sociale.
18	10661	Strehimi social

Institucione varësie bashkia Kolonjë ka 2 , ku përfshihet Sporti dhe argëtimi me 1 progam buxhetor 08130 dhe Kultura me 2 programe buxhetore 04130 Zhvillimin e turizmit dhe 08220 trashëgimnia kulturore ,evente artistike.

I - Buxheti 2023

Buxheti I Bashkisë Kolonjë për vitin 2023 është miratuar me VKB nr 147, datë 22.12.2022 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2023” , si dhe disa shtesa te ardhura nga pushteti qendror në periudhën janar-dhjetor 2023 kryesisht shtesa e bërë nga qeveria për ndryshimin ne nivelin e pagave,shtesa per shlyerjen e detyrimeve te prapambetura,investim ne process si dhe fondi I paftesise

1. Raporti i shpenzimeve sipas programeve

Referuar ANEKSIT nr. 1 "*Raporti i shpenzimeve sipas programeve*" për periudhën janar-dhjetor 2023.

Emri i grupit		Kodi i grupit						
Programet		Shpenzimet e njësisë së vetëqeverisjes vendore						
Titulli	Emërtimi	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	(2) PBA Viti 2023	(3) Buxheti vjetor Plan Fillestar Viti 2023	(4) Buxheti vjetor Plan i rishikuar Viti 2023	(5) Buxheti vjetor Plani i Periudhës/progresiv	(6) Fakti i Periudhës/progresiv	Perqindja e Realizimit
0001	01110	54633	61647	61647	61390	61390	59049	96%
0002	03140	4792	6378	6378	5538	5538	4749	86%
0003	03280	18080	20046	20046	24167	24167	21562	89%
0004	04220	4436	5962	5962	5656	5656	5270	93 %
0005	04240	17314	19240	19240	18929	18929	18259	96%
0006	04260	20078	34129	34129	35121	35121	23652	67%
0007	04520	11506	9909	9909	19090	19090	18637	98%
0008	05100	22479	26030	26030	28237	28237	27362	97%
0009	06140	4157	5954	5954	4154	4154	3548	85%
0010	06260	56383	58096	58096	96528	96528	74200	77%
0011	09120	44761	46957	46957	52669	52669	47695	91%
0012	09230	12780	15619	15619	15955	15955	11842	74%
0013	10430	124247	7360	25760	128753	128753	121830	95%
0014	10661	2300	2517	2517	3232	3232	2808	87%
0015	08130	5942	7130	7130	8672	8672	8398	97%
0016	08220	7864	11305	11305	17891	17891	17534	98%
0017	04130	8318	5750	5750	5150	5150	5148	100%
0018	06370	419222			147827	147827	139486	94%
0019	04130	1190			68	68	44	65%
0020	01170	2971		2980	4234	4234	3773	89%
0021	466	3666			1202	1202	1202	100%
0022	06190	2579			2525	2525	2390	95%
0023	01620				1501	1501	1500	100%
0024	10910	7197			28781	28781	25216	88%
.....							0.0
Totali i shpenzimeve të njësisë		856895	344029	365409	717270	717270	645154	90%
Totali		856895	344029	365409	717270	717270	645154	90 %
Kryetari i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore		Emri	Erion Isai					
		Firma						
		Data						

A) Plani fillestar i buxhetit pa përfshirë investimet e çelura nga Ministritë përkatëse ishte 344.029 mijë lekë , plani buxheti vjetor 2023 (duke përfshirë dhe investimet e çelura nga Ministritë përkatëse + fondet e ndihmës ekonomike dhe paaftësisë është 717.270 mijë lekë

Shtesat e buxhetit vitit 2023 janë kryesisht nga :

- a) Shtesa fondesh nga buxheti i shtetit për transferta në buxhete familjare & individë (ndihma ekonomike apo/dhe paaftësia) shtese për ndryshimin e nivelit të pagave.
- b) Investimet e çelura nga qeveria për bashkinë Kolonjë.

B). Shpenzimet faktike në fund të dymbëdhjetmuorit të vitit 2023 janë realizuar në shumën 645,154 mijë lekë, plani i buxhetit për këtë periudhë është 717,270 mijë lekë ,(sipas situacionit të shpenzimeve të kuadruar me degën e Thesarit Kolonjë ose në masën 90% me një diferencë mosrealizimi -72,116 mijë lekë .

C) Struktura buxhetore me çeljen e investimeve dhe fondeve të ndryshme nga Ministritë përkatëse janë 24 programe buxhetore nga të cilat 20 programe buxhetore janë më realizim buxheti 12- muor mbi 80 % , deri 80 % realizim buxheti janë 4 programe buxhetore .

Aneksi nr 1 paraqet shpenzimet sipas programeve buxhetore e paraqitur në tabelën e mësipërme në total të shpenzimeve , me faktin e vitit 2022, plani fillestar I PBA-së , buxheti fillestar + shtesat e buxhetit , buxheti i periudhës 12 mujore si plan dhe fakti I periudhës 12 mujore .

2. Raporti i shpenzimeve sipas artikujve :

Referuar ANEKSIT 2 "*Raporti i shpenzimeve të programeve sipas artikujve*", jep shpenzimet të grupuara sipas artikujve për të gjitha programet buxhetore konkretisht .

Pagat artikulli 600 , planifikua për periudhën 12 mujore 172,589 mijë lekë , realizuar 165,643 mijë leke ose 96 % me një diferencë – 6946 mijë e cila vjen si rezultat I mosplotësimit të stukturës buxhetore në disa programe buxhetore .

Sigurimet shoqërore dhe shëndetsorë artikulli 601 ,planifikuar në shumën 28,644 mijë , realizuar në shumën 27,246 mijë ose 95 % me një diferencë prej -1398 mijë me të njëjtin argument justifikues si në pagat .

Shpenzimet operative planifikuar 137,378 mijë , realizuar 113,344 mijë ose 83 % ,me një diference -24034 mijë pjesa e mosrealizimit vjen kryesisht nga mungesa e realizimit 100% te mbledhjes te taksave dhe tarifave.

Shpenzimet kapitale artikulli 230 + 231 planifikuar 250,962 mijë ,realizuar 217,253 mijë ose 87 % me një diferencë prej -33,709 mijë lekë me argument justifikues diferenca e fondit limit dhe ofertës fituese si dhe argument po njesoj si tek mosrealizimi I shpenzimeve operative.

Nga ana e drejtorisë së financës janë realizuar pothuajse mbi 90% blerjet për mallra dhe shërbime me qëllim vazhdimësinë e puneve dhe shërbimeve të cilat janë bërë me punonjësit dhe mjetet e bashkisë .

Detyrimet në fillim të vitit 2023 kanë qënë 303 mijë , detyrime të cilat po shkojne drejt zerimit.

Në shërbim të komunitetit .

	BASHKIA KOLONJË						
	DREJTORIA E TË ARDHURAVE						
EVIDENCA E REALIZIMIT TË TË ARDHURAVE 12 MUJORI 2022 -2023							
Nr.	E M E R T I M I	12-mujori 2022		Realizim%	12-mujori 2023		Realizim%
		PLAN	FAKT		PLAN	FAKT	
1	2	5	6	7(5:6)	5	6	7(5:6)
A	TAKSA VENDORE	17,556	21,282	121.2%	17,556	16,792	102.4%
1	Takse Pasurie	3,369	4,134	122.7%	3,369	4,114	122.1%
1/1	Subjekte Fizik	1,000	2169	216.9%	1000	490	49.0%
1/2	Subjekte juridike	465	403	86.7%	707	742	105.0%
1/3	Institucione	10	90	900.0%	10	91	910.0%
1/4	Për ndertesa Banimi	1,894	1472	77.7%	1894	3001	158.4%
2	Taksë mbi Truallin	58	0	0.0%	58	0	0.0%
3	T. vendore, biznesi I vogël	280	122	43.6%	280	23	8.2%
4	Tak. Regjistrim Automjete	3,800	4618	121.5%	3800	5130	135.0%
5	Taksë Nd. Ne infra. (Nd te reja)	3,200	949	29.7%	3200	1288	40.3%
6	Të ardh nga hotele	135	11	8.1%	135	32	23.7%
7	Taksë e Kalimit të pronesisë	-	48	#DIV/0!	0	0	#DIV/0!
8	Taksë për Tabele dhe Reklame	360	595	165.3%	360	531	147.5%
9	Taksë Kontrolli Veterinar	4	2	50.0%	4	0	0.0%
10	Tap	900	8575	952.8%	900	4609	512.1%
11	Renta Minerare	50	0	0.0%	50	1	2.0%

12	Taksa mbi tokën bujqesore	5,400	2228	41.3%	5400	2270	42.0%
B	TARIFAT VENDORE	61,907	40,995	66.2%	58,992	40,067	67.9%
1	Tarife Pastrimi	9,262	9,701	104.7%	9,962	9,594	96.3%
1/1	Subjekete Fizik	3,650	3215	88.1%	3650	1925	52.7%
1/2	Subjekte juridike	2,282	2578	113.0%	2282	3490	152.9%
1/3	Institucione	830	905	109.0%	830	1000	120.5%
1/4	Tarifë për ndertesa Familjare	2,500	3003	120.1%	3200	3179	99.3%
2	Tar. Nd. Urban e mirembajtje	5,614	5,467	97.4%	5,814	4,362	75.0%
2/1	Subjekte Fizik	2,000	1912	95.6%	2000	492	24.6%
2/2	Subjekte juridike	800	816	102.0%	800	1042	130.3%
2/3	Institucione	514	484	94.2%	514	464	90.3%
2/4	Tarifë për Familje	2,300	2255	98.0%	2500	2364	94.6%
3	Tar.Zenie Hap Publike	390	360	92.3%	390	353	90.5%
4	Tregu	700	416	59.4%	700	387	55.3%
5	Tarife Parkim automjete	220	109	49.5%	220	116	52.7%
6	Tarife regjstrim biznesi	50	50	100.0%	50	140	280.0%
7	Tarife per leje a certifikate	160	98	61.3%	160	248	155.0%
8	Tarife Sherb. Administ Gj.civil	1,200	3926	327.2%	1200	869	72.4%
9	Tarifë kullote + pyjore	3,700	1950	52.7%	3700	2070	55.9%
10	Tarifë dru zjarri	22,824	5600	24.5%	18924	7304	38.6%
11	Ujitje dhe Kullim	300	320	106.7%	300	278	92.7%
12	Tarifë peshkimi	100	0	0.0%	100	0	0.0%
13	Hece	4,000	2437	60.9%	4000	3447	86.2%
14	Qera Antene	7,000	4314	61.6%	7000	5400	77.1%
15	Toka me Qera	3,600	4132	114.8%	5752	5288	91.9%
16	Fond pyjor me qera	100	0	0.0%	100	0	0.0%
17	Prodhime te dyta		0	0.0%	100	0	0.0%

	pyjore	100					
18	Tarifë shërbim për Qytetaret mjete	20	0	0.0%	20	0	0.0%
19	Tarifë E përkohshme Turizmi	2,067	1642	79.4%	0	0	0.0%
20	Tarifë per Linja Nëntokesore Ajrore	100	0	0.0%	100	0	0.0%
21	Taksë Prone Private Pyll.kullote	400	473	118.3%	370	216	58.4%
C	Gjoha dhe Mosshlyerje në Afat të detyrimit	200	84	42.0%	800	202	25.3%
1	Mosshlyerje të detyrimeve Tataimore	-		#DIV/0!	600	161	26.8%
2	Gjoha nga kontrolli dhe inspektimeosshlyerje në Afat të detyrimit	200	84	42.0%	200	41	20.5%
	Llojet e dhe niveli e gjobave për kundravjte Administrative	-		#DIV/0!			#DIV/0!
4	Gjobave per ndotje te hapësire publike ndotje aksutike	-		#DIV/0!			#DIV/0!
5	Gjoha per nderyrje ne infrastrukture rrugore	-		#DIV/0!			#DIV/0!
6	Gjoha për kryerjen e aktivitetet tregetar pa liçense,autorizim etj.	-		#DIV/0!			#DIV/0!
7	Gjoha për dëmtime dhe nderhyrje në rrjetin e ndricimit rrugor U.k.z	-		#DIV/0!			#DIV/0!
8	Gjoha për ndërhyrje,dëmtime në Hapesirat e gjelbra dhe fasada	-		#DIV/0!			#DIV/0!
9	Gjoha në sektorin e bujqesië,pyjore dhe bordi I kullimit	-		#DIV/0!			#DIV/0!
10	Gjoha për përdorim të logos se Bashkisë	-		#DIV/0!			#DIV/0!
11	Gjoha për demtim të objekteve të rendesisë së veçantë	-		#DIV/0!			#DIV/0!
12	Gjoha për inspektim veterinar	-		#DIV/0!			0
D	Të ardhura jo tatimore	72	473	656.9%	462	808	174.9%
1	Të ardhura nga dhenia me qera e aseteve te bashkisë	72	230	319.4%			#DIV/0!
2	Të Ardhura nga sekuestrimet dhe	-		#DIV/0!	0	0	0%

	zhdemtimet						
3	Të Ardhura nga Shitja e mallrave dhe shërbimeve,aseteve te bashkise	-	0	200.0%	0	0	0%
4	Të ardhura nga Çerdhja		360	#DIV/0!	400	486	121.5%
E	Detyrime të pa mbledhura në vite	1,000	3139	313.9%	4000	4805	120.1%
F	Shuma (A+B+C+D+E)	80,735	65,973	81.7%	81,810	63.942	78.1%
G	Të ardhura kultura ,muze,biblotekë	180	116	64.4%	190	76	40.0%
1	Biblotekë muze	60	91	151.7%	60	0	0.0%
2	Të Ardhura Kultura	120	20	16.7%	130	76	58.5%
	Shuma totale (F+G)	80,915	66,089	81.7%	82,000	63.942	78.1%

Të ardhurat tatimore ,për 12-mujorin e vitit 2023 u realizuan në shumën 17.987 mije ose 102.4% nga plani si 12-mujore,nëse bën krahasim me vitin 2022 ku si 12-mujor u realizua në shumën 22.282 mijë lekë ose 121.2% e planit , për vitin 2023 janë arkëtuar 4.304 mijë lekë më pak se në vitin 2022 .

Taksa e regjistrimit të automjeteve kjo është një taksë që dërgohet nga Drejtoria e Kontrollit dhe Transportit të automjeteve për vitin 2023 në shumën 5.130 mijë ndërsa në vitin 2022 është 4.618 mijë me një ritje prej 512 më shumë .

Taksa e ndikimit në Infrastruktura si 12-mujor ka pësuar ritje me 339 mijë lekë krahasuar me vitin 2022 pasi ka pasur leje ndërtimi dhe leje për punime të vogla .

Të ardhurat jotatimore për 12-mujorin e vitit 2023 u realizuan në shumën 40.073 mije ose 67.9% nga plani si 12-mujore,nëse bën krahasim me vitin 2022 ku si 12-mujor u realizua në shumën 40.995 mijë lekë ose 66.2 % e planit , për vitin 2023 kemi pasur një ulje të planifikimit të të ardhurave jo tatimore për arsye se kemi pasur largim familjesh në masë nga njesitë administrative dhe është realizuar e njejta vlerë lekesh por në përqindje më të lartë.Mos realizimi e planit 12-mujor për vitin 2023 janë ulja e numrit të bizneseve fizike ,largimi i familjeve nga njesitë administrative ,si dhe disa kontrata antenash dhe Hece që kanë mbaruar dhe nuk është bërë rinovimi i tyre nga ana e drejtorisë së pyjeve gjë që ul realizimin e të ardhurave .

Shpenzimet sipas programeve paraqiten si më poshtë:

Zhvillimi i njësisë ,menaxhimi i financave të njësisë së vetëqeverisjes vendore ,të burimeve të tjëra si dhe burimeve njerëzore ,funksionimi i proceseve të përgjithëshme të brendëshme dhe komunikimi me publikun
Shërbime në mbështetje të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të këshillit .

01110 . Planifim, menaxhim dhe administrim

- Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të përgjithëshme për personelin.
- Shërbime të përgjithëshme për publikun , si shërbimet e prokurimit , mbajtja dhe ruajtja e dokumentave dhe arkivave të njësisë , ndërtesat në pronësi apo të zëna nga njësia ,zyrat e IT .
- Administrim ,funksionim dhe afrimi i shërbimeve të mbështetjes për kryetarin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ,për këshillin ose komisionet e këshillit .
- Shërbimet statistikore dhe bazat e të dhënave vendore .
- Prodhim dhe përhapje e informacionit publik ,dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet për zhvillimin e komunitetit .
- Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve financiare dhe fiskale, menaxhim i fondeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore, i borxhit dhe funksionim i skemave të taksimit,
- Bashkërendimi me degën e thesarit , zyra e buxhetit,administrata e të ardhurave.
- Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet financiare dhe fiskale.
- Planifikimi i përgjithshëm dhe shërbimet statistikore, duke përfshirë formulimin, bashkërendimin dhe monitorimin.

Qëllim

- ✓ Qeverisje vendore e përgjegjeshme dhe administratë transparente .
- ✓ Përmirësimi i kapaciteteve të bashkisë për ritjen e cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit .
- ✓ Të rriten kapacitetet financiare për të mbështetur shërbimet ndaj komunitetit .

Objektivat

1. Të rritet qëndrueshmëria në administratën civile .
2. Ritja e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve ne vendimarrje me 30% çdo vit .
3. Përmirësimi i stafit të bashkisë .
4. Përmirësimi i shërbimit dhe informacionit në një kohë të shpejtë dhe me cilësi nëpërmjet sistemit të zyrës me një ndalesë.
5. Ritja e % së grave në punë në bashki / numurit total të punonjësve
6. Ritja e % së grave në drejtim / numurit total të drejtuesve nga 40 % aktualisht të arrijmë në 50 % ky raport
7. Sigurimi i kushteve optimal për të gjithë punonjësit e Bashkisë

8. Përmirësimi i financave të bashkisë nëpërmjet mbledhjes së të ardhurave të planifikuara nga taksat dhe tarifave vendore , duke punuar për uljen e informalitetit e cila con në ritjen e numrit të subjekteve të liçensuara .
9. Menaxhimi me efektivitet i të gjitha burimeve financiare duke ulur detyrimet e prapambetura të pa paguara deri ne zero.
10. Situata financiare e bashkisë të mbahet më e vogël se 15 % të (raporti detyrime të papaguara / totalit të shpenzimeve operative)

Prokurti

Punonjës të kualifikuar dhe staf transparent, gra në drejtim dhe në vendimarrje .
Të ardhura sipas planit , shëndoshjen e gjendjes financiare të bashkisë ,zbutje e detyrimeve të papaguara .

Treguesit e performances/produktet .

- ✓ Ritja e qëndrueshmërisë së administratës civile që ka të bëjë me nr e punonjësve që lëvizin brenda vitit në krahasim me nr total të punonjësve .
- ✓ Përmirësimi i punës së stafit të bashkisë që ka të bëjë më masat disiplinore të marra nga stafi i bashkisë .
- ✓ Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë (ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar)
- ✓ Raporti i numrit totali të ditëve të trajnimeve kundrejt numrit total të personave të trajtuar (mesatarisht ditë trajnimi për person në vit)
- ✓ Nr i grave dhe burave në punë
- ✓ Nr i grave dhe burave në drejtim
- ✓ Nr i grave dhe burave në trajnime
- ✓ Mbyllja e bilancit vjetor më një bilanc të drejtë midis të ardhurave dhe shpenzimeve të dalë jo negative .
- ✓ Përmirësimi i mbledhjes së të ardhurave të veta dhe ritja e të ardhurave nga menaxhimi i aseteve të bashkisë .
- ✓ Zbutja e detyrimeve të prapambetura të papaguara në fund të vitit deri në 80 % të totalit

Rezultat .

- ✓ Bilanc vjetor pa defiçit (pa detyrime të prapambetura të pa paguara të cilat mbarten në buxhetin e vitit pasardhës), të cilat çojnë në shëndoshjen e financave vendore.

Realizimi I treguesve të performancës

- Nr i grave në pozicione drejtuese 11 ndaj 11 pozicioneve që drejtohen nga burat ose raporti 50/50

Këto shpenzime janë planifikuar në funksion të realizimit të objektivave që ka Bashkia për këtë program .

Në këtë program buxhetor shpenzimet operative art 602 është shpenzuar për blerje kancelarie dhe tonera për administratën , pagesa e detyrimeve ndaj të tretëve (ujë , energji , internet dhe postë) shpenzime për regjistrimin e aseteve të bashkisë në ZVRPP , pagesën e përmuajshme të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave , pagesën e nxënësve ekselentë të maturës 2023, karburant dhe vaj si dhe mirëmbajtja e tyre për makinat që përdoren nga titullarët e institucionit .

- ✓ Mbledhja e të ardhurave për 12-mujorin e vitit 2023 është në masën 78 % nga 82 % që ishte në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar me një diferencë në vlerë prej 2147 lekë.
- ✓ Nuk janë krijuar detyrime të reja .

Programi 03140 “ Sherbimet Policore

- Sigurim, i mbrojtjes ,qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda teritorit të njësisë në përputhje me dispozitat ligjore.
- Ekzekutimi dhe zbatimi i akteve të nxjera nga Kryetari dhe vendimet e Këshillit Bashkiak .

Qëllimi

- ✓ **Përmirësimi i sigurisë së komunitetit nëpërmjet shërbimit të policisë bashkiake**

Objektivat

1. *Ritja e cilësisë së shërbimeve bashkiake për sigurinë dhe qetësinë publike në komunitet duke rritur nr e trajnimeve për punonjësit e policisë bashkiake.*
2. *Marja e masave për parandalimin e të gjitha problematikave që kanë të bëjnë me rendin dhe qetësinë publike,pronësi dhe menaxhimin e të gjitha konflikteve që kanë motive pronësie dhe që kërkojnë ndërhyrjen e policies bashkiake .*
3. *Ritje e rasteve të menaxhuara nga ana e policisë bashkiake duke rritur dhe bashkëpunimin me policinë e rendit .*

Realizimi I Treguesit performancë / produktivitete

- ✓ *Nr rastesh të raportuara nga popullata tek policia bashkiake 75 për periudhën e 12 mujorit të vitit 2023.*
- ✓ *Raste të menaxhuara nga policia bashkiake 75 nga 40 të planifikuara*
- ✓ *Kontrolle të ushtruara nga policia bashkiake 85 nga 90 të planifikuara ose 94 %*
- ✓ *Kontrolle të ushtruara në bashkëpunim me policinë e shtetit dhe drejtorinë e shëndetit publik 22 .*
- ✓ *Zbatime vendimesh të ndryshme 27 nga 40 të planifikuara ose 68 % realizim.*
- ✓ *Menaxhimi I aktiviteteve kulturore e sportive të ndryshme 45 nga 45 të planifikuar ose 100%,*

Rezultati

Zgjidhje te konflikteve , shtimi i cilësisë së shërbimit në komunitet ,garatimin e sigurisë së pronës

Impakti

Jetesë më e mirë , më e sigurt për të gjitha moshat fëmijë ,gra ,burra e të moshuar .

Programi **03280** 'Mbrojtja nga zjarri dhe shërbimet civile “

Vështrim i përgjithshëm i programit

- Funksionimi i njësive zjarfikëse dhe i shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit .
- Shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimit malore, evakuimi i zonave të përmytura etj.
- Mbështetja e programeve trajnuese të parandalimeve dhe mbrojtjes kundër zjarrit .

Qëllimi

- ✓ Është inspektimi, parandalimi, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut.

Ojektivat

1. Përmirësimi i shërbimeve dhe infrastrukturës së shuarjes së zjarrit dhe shpëtimit nëpërmjet uljes së rasteve problematike ,reagim më të shpejtë ndaj njoftimeve për zjarrin ,përmirësimit të shërbimit të parandalimit të zjarrit .
2. **Treguesit e performancës**
 - ✓ Reagimi më i shpejtë ndaj njoftimeve për zjarret , me ndryshim sekondash të daljes nga stacioni
 - ✓ Nr i stacioneve të MZSH
 - ✓ Nr i inspektimeve dhe vizitave tek të tretët
 - ✓ Nr rastesh të menaxhuara

Realizimi I treguesve të performancës

1. Nr stacionesh të MZSH 2
2. Nr inspektimesh të kryera lidhur me rreziqet e zjareve në pyje dhe banesa 80 të realizuar / 80 të planifikuara ose 100 % realizim
3. Nr i rasteve të menaxhuar 228
4. Takime ndërgjegjësuese për parandalimin e rasteve të zjarreve në pyje dhe kullota si dhe organizimi I mësimave treguese me komunitetin dhe shkollat 45 të realizuara / 45 të planifikuara = 100 %

5. Aktivitete shërbimi 750

Rezultatet

Objekte, prona dhe jetë njerzish të shpëtuar.

Impakti

Jetesë më e sigurt për të gjitha moshat ,si dhe pronë më të garantuar nga zjarri dhe përmbytjet .

Programi 04220 “ Shërbimi bujqësor ,ispektimi dhe siguria ushqimore.

Vështrim i përgjithshëm i programit

- Ngritja, plotësimi, ruajtja dhe përditësimi i një sistemi informacioni mbi bazë parcele për tokën bujqësore, që të përmbajë informacion për vendndodhjen e saktë,
- përmasat dhe pronësinë e parcelave.
- Prodhimi dhe përhapja e informacionit të përgjithshëm,dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet bujqësore.
- Administrimi dhe mbrojtja e tokës bujqësore dhe kategorive të tjera resurse .
- Organizim ose mbështetje e shërbimeve veterinarë për blegtorinë.
- Kontrolli ushqimor dhe mbrojtja e konsumatorëve .

Qëllimi

- ✓ Rritja e produkteve bujqësore dhe blegtorale .
- ✓ Mbrojtja e tokës bujqësore nga gryerjet dhe përmbytjet
- ✓ Rritja e sigurisë ushqimore për konsumatorët

Objektivat

1. Mbështetja e rritjes së prodhimit bujqësor dhe blegtoral nëpërmjet rritjes së numurit të inspektimeve dhe kontrolleve në teren si dhe zgjidhjes së konflikteve pronësorë me 480 raste për 12 mujorin e vitit 2023.
2. Mbrojtja e tokës bujqësore nga përmbytjet duke bërë 3 prita malore në vitin 2023 e cila mbron rreth 50 ha tokë,

Treguesit e performancës

Rritja e sigurisë së konsumatorëve
Sistem i ngritur për regjistrimin e akteve të pronësisë
Ritja e të ardhurave nga tokat bujqësore të pandarave bashkisë nëpërmjet dhënjes më qera të tyre
Ndihmë për familjet bujqësore me konsuktime , këshillime dhe zgjidhje konfliktesh .
Nr pritash të ndërtuara për mbrojtjen e tokës nga përmbytjet 3 prita për rreth 75 ha tokë .

Realizimi i Treguesve të performancës

- ✓ Rastë inspektimi të kontrollit ushqimor 1550 nga 1500 të planifikuara për 12 mujorin e vitit 2023= 103 %
- ✓ Konsultime me publikun ,këshillim me fermerët e teritorit të bashkisë dhe saktësimin pronësie 480/ nga 450 të planifikuara ose 106 %
- ✓ Dhënie tokash më qera 1 të planifikuara ,të cilat shtojnë të ardhurat nga dhënja me qera e aseteve të bashkisë.
- ✓ Regjistrimi në database i nr të blegtorisë së rrethit

Rezultati

Prodhime bujqësore dhe blegtorale më të ritura , toka më të mira dhe më funksionale , siguri ushqimore e garantuar , database për tokat e shpërndara fermerëve sipas një sistemi elektronik .

Impakti

Ritje e nivelit të jetesës kyesisht në fshat ,prodhime bujqësore organike të prodhuara nga fermerët vendas sipas stinëve nëpërmjet shitjes së tyre në treg .

Në mbështetje të rritjes së prodhimeve bujqësore dhe blektorale është rritur numuri i ispektimeve për minimizimin e sëmundjeve dhe infeksioneve të prodhimeve bujqësore që çojnë në rritjen e prodhimit bujqësor dhe blektoral. Zgjdhjen e konfilkeve të pronësise lidhur me saktësimin e pronave saktësuar konflikte me pronësine, janë regjistura certifikat pronësie dhe janë marrë masa për mbrojtjen e tokës nga gryerjet e lumenjve duke ngritur sfrate në ato vende ku rrezikohej përmytja.Jane kryer ispektime në

raste lidhur me kontrollin ushqimor në funksion të ruajtjes së sigurisë ushqimore. Përbushja e detyrave funksionale dhe realizimi i treguesve të performancës për këtë program buxhetor është I ndërthurur më programin buxhetor të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit .

04240 "Menaxhimi infrastruktures ujitje kullimit"

1. Ndërtim ose organizim i sistemeve të kontrollit të përmytjeve , të ujitjes dhe kullimit , duke përfshirë grandet për punime të tilla .
2. Administrim ,shfrytësim dhe mirëmbajtje e infrastrukturës se ujitjes dhe kullimit nën përgjegjesinë e njësive të vetqeverisjes vendore .

Qëllimi

- ✓ Të përmirësojë shërbimin e ujitjes dhe kullimit nëpërmjet pastrimit dhe mirëmbajtjes së kanaleve dhe ujëmbledhësave me synim rritjen e prodhimeve bujqësore dhe mbrojtjen nga përmytjet , duke pastruar 80 km kanal ujitës , duke ujitur 2283 ha tokë dhe 80 km kanal kullues e cila do të përmirësojë kullimin në 160 ha tokë bujqësore për vitit 2023.

Ojektivat .

1. Përmirësimi i sistemit të ujitjes duke pastruar 80km kanal ujitës për vitin 2023 e cila do të përmirësojë ujitjen në një sip prej 2283 ha tokë bujqësore.
2. Përmirësimi i sistemit të kullimit duke pastruar 12 km kanal kullues për vitin 2023 e cila do të përmirësojë aftësinë kulluese në një sip prej 160 ha toke .
3. Të pastrohen dhe zhblllokohen 2 ujëmbledhësa për vitin 2023.
4. Të rehabilitohen 44 vepra marje uji (sfrate) për cdo vit , për ujitjen e 550 ha tokë bujqësore.

Treguesit e performancës

- ✓ Ritja e sipërfaqes të mbuluar me ujitje
- ✓ Ritja e sipërfaqes të mbuluar me kullim
- ✓ Ritja e nr të familjeve përfituese
- ✓ Lekë të shpenzuar për 1 km kanal
- ✓

Realizmi i treguesve të performancës/ produkti

Realizmi i treguesve të performancës

- Sip e përmirësuar me ujitje 475 ha
- Gjatësi kanalesh ujitëse të pastruar 70 km
- Mirëmbajtje e shkarkuesve katastrofikë nr 5 në , Kabash –Leskovik,Radanj, Shtikë Kabash – Ersekë , Kagjinas
- Mirëmbajtja e kanaleve furnizues të rezervuarëve nr 3 .
- Inspektim në digat e 24 rezervuarëve me 2 herë në muaj.

Risku

1. **Pronesia e tokës e cila mund të sjellë pengesë në zbatimin e projekteve** në kohë .
2. Mundësia e rënjes së rreshjeve të shiut ,e cila mund të shkaktojë dëmtimin e sfrateve .

Rezutati i pritshëm .

Mbrojtjen e tokës bujqësore ,rritja e sipërfaqes së ujitjes dhe kullimit , si dhe rritja e sigurisë së digave e cila do të cojë në rritjen e prodhimeve bujqësore në funksion të rritjes së mirëqenies ekonomike të fermerëve .

Impakt

Kushte më të mira dhe të përshtatëshme për të punuar dhe prodhuar për të gjithë fermerët e njesivë administrative.

04260 "Programi pyje e kullota"

1. Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve pyjore;
2. Konservim, zgjerim dhe shfytëzim i racionalizuar i

rezervave pyjore

3. Adminstrimi i fondit pyjor dhe kullisor .
4. Mbikëqyrje e operacioneve pyjore dhe dhënie e liçencave për prerje drurësh (hedhja e pemëve);
5. Organizimi ose mbështetja për veprimtari ripyllëzuese , kontrollet e dëmtuesve dhe sëmundjeve , shërbimi pyjor për luftën kundër zjarrit dhe parandalimin e tij si dhe afrimi i shërbimeve për operatorët pyjorë
6. Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet pyjore;
7. Shpërndarja e kullotave, duke përfshirë menaxhimin e kullotjes
8. Administrim i çështjeve dhe shërbimeve të peshkimit dhe gjuetisë; mbrojtje, shtim dhe shfrytëzim racional të peshkut dhe kafshëve të egra, mbikëqyrje dhe disiplinim i peshkimit në ujëra të ëmbla, kultivimit të peshkut, gjuetisë së kafshëve të egra dhe liçensave të gjuetisë.

Qëllimi

- ✓ Të sigurojë përdorim të qëndueshëm në pyje e kullota , duke ritur të ardhurat në pyje e kullota ,ritjen e nr të inspektimeve të fondit pyjor e kullisor si dhe përmirësimi i fondit pyjor e kullisor .

Objektivat

1. Ritja e produkteve nga pyjet dhe kullotat nëpërmjet hartimit të planit të mbarështimit 10 vjeçarë e cila do të sigurojë dru zjari për popullatën për rreth 19.000 banorë në një sasi prej 3000 ms në një sip prej 1000 ha për vitin 2023 e cila do të sjellë dhe ritjen e të ardhurave me mesatarish 5.000 lekë .
2. Të ritë nr e kontroleve dhe inspektimeve në teren me nga 10 në cdo vit për të shmangur dëmtimet në fondin pyjor .
3. Të ndërtohen 1 lera për vitin 2023, e cila u shërbyen nga 5000 – 7000 krerëve në vitin 2022, dhe 1 koritë për vitin 2023 , cilat u shërben reth 1000 krerëve .

Produkti

1. Sigurojmë dru zjari për popullatën ,si dhe rritim të ardhurat e bashkisë nga shitja e tyre , do të minimizohen dëmtimet e pyjeve dhe kullotave dhe do të përfitojme lera dhe korrita për të pirë ujë blegtoria në zon
2. a ku do të kullosin

Treguesit e performancës

- ✓ Ritja e të ardhurave nga sektori pyjor dhe kullisor
- ✓ Planet e menaxhimit të fondit pyjor
- ✓ Ritja e inspektimeve të fondit pyjor e kullisor

Realizimi i treguesve të performancës / produktet

- ✓ Janë realizuar kontrolle dhe inspektime në pyje 180 nga 180 të planifikuar ose 100 %.
- ✓ Janë lidhur kontrata qeraje për përdorim të fondit kullisor bashkiak në 47 nga 37 të planifikuara = 127 %

- ✓ Janë sekuestruar nga kontrollet e ushtruara lëndë drusore në 33.6 m³
- ✓ Eshte ndertuar 1 lere dhe nje korite për të pirë ujë blegtoria në zona ku do të kullosin
- ✓

Rezultati

Drru zjari për ngrohje për popullatën , institucionet arsimore dhe të bashkisë , përfitimi i lerave dhe koritave funksionale për të pirë ujë blegtoria .

Impakti

Kushte të mira dhe optimale ngrojeje për popullatën ,kushte optimal për zhvillimin e mësimin dhe të punës ,

Garantimi dhe sigurimi i kushteve të mira për blegtorinë kryesisht në zonat e larta malore .

04520 Rjeti rrugor rural

- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit,rruge ,ura
- Studime për rehabilitimin , përmirësimin e rjetit rrugon në administrimin e njësisë vendore.

Qëllimi

- ✓ Zhvillimi social dhe ekonomik nga komunikimi ndërurban , sigurimi i aksesit rrugor për të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Kolonjë tek shërbimet bazike (qendra shëndetsore dhe shkollat publike).

Ojektivat

1. Rehabilitim i rjetit rrugor në njësitë administrative të Bashkisë Kolonjë me 55 Km për vitin 2023.
2. Mbajtja në gadishmeri e 135 km rruge rurale të cilat bllokohen nga rreshjet e dëborës në stinën e dimrit.

Produkti

Rruge të mirëmbajtura , funksionale dhe në shërbim të komunitetit .

Treguesit e performancës

- ✓ Përmirësimi i rjetit rrugor rrural dhe urban duke mbajtur km rrugë vendore funksionale
- ✓ Zgjerime të rjetit rrugor rrural
- ✓ Përmirësimi i sigurisë rrugore

Realizimi i treguesve / produktet

Këto punime janë kryer me mjetet dhe punonjësit e sektorit të rrugëve rurale dhe të shërbimeve .

- Zgjerim ,çakullim dhe hapje kanale anësore në rrugët 55 km nga 55 të planifikuara

- Janë përballuar emergjencat e dimrit ,bllokimet e rrugeve nga dëborat si dhe nga rreshjet e shirave në njësitë administrative Mollas,Q.Ersekë ,Barmash,Leskovik.
- Jane mbajtur ne gadishmeri 135 km rruge rurale.
- Eshte bërë skalerifikim ,hapje kanal anësor shtrim me cakull dhe ngjeshje me rul në fshatrat Boshanj ,Radat Bobicke ,Radajn,Skorovot.

Rezultati

Sigurimi i kushteve më të mira për lidhjen e fshatrave të njërive administrative me qendën urbane ,lëhtësimin e transportit dhe tregëtimit të prodhimeve bujqësore dhe blektorale ,eliminim e aksidenteve rrugore , përmirëson kushtet e shërbimit ambulator dhe rasteve e emergjencave shëndetësore.

Impakti

Jetësë më e mirë për të gjitha moshat , të rinj ,gra , fëmijë dhe të moshuar , mos shpopullim i zonave rurale .

04130. Zhvillimi i turizmi .

Administrimi i çështjeve dhe turizmit vendor, Promovimi dhe zhillimi I turizmit vendor. Funksonimi I zyrave turistike vendore, organizimi I fushatave publicitare duke përfshirë prodhimin dhe shpërndarjen e literaturës promovuese/ Përmirësimi I hapësirave pamore, urbane të Bashkisë dhe mirëmbajtjen e objekteve kulturore turistike që nxisin rritjen e vizitoreve duke I kthyer ato ne atraksione turistike te njesise vendore.

Qellimi

Rritja e ekonomisë vendore përmes turizmit malor, historik, kulturor natyror, kulinar etj Përmirësimi I shërbimit të promovimit të turizmit Duke qënë se është viti I parë krijimi I zyrës për promovimin e Kolonjës do te duhet të fillohet pothuajse nga e para. Qëllimi është qe të kemi vizitorë sa më të orientuar për vëndet apo objektet (monumente kulture dhe natyre) që do të duhet të vizitojnë apo ku mund të marrin shërbimin e ushqimit apo fjetjes (restorante apo hotele). Nje qellim tjetër është evidentimi dhe promovimi I vlerat e trashëgimise kulturore te folklorit, dhe ruajtjes se traditave te zones Shtimi I numrit të të vetëpunësuarve në agroturizëm

Objektiva

- Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve të turizmit vendor, promovimi dhe zhillimi i turizmit vendor.
- Funksonimi i zyrave turistike vendore, organizimi i fushatave publicitare duke përfshirë prodhimin dhe shpërndarjen e literaturës promovuese.
- Përmirësimi i hapësirave pamore, urbane të Bashkisë dhe mirëmbajtjen e objekteve kulturore turistike që nxisin rritjen e vizitoreve duke i kthyer ato ne atraksione turistike te njesise vendore.

Qellimi

- ✓ Rritja e ekonomise vendore përmes turizmit malor, historik, kulturor natyror, kulinar etj
- ✓ Përmirësimi i shërbimit të promovimit të turizmit
- ✓ Shtimi i numrit të të vetëpunësuarve në agroturizëm

Objektiva

1. Vendosja e tabelave informuese për vizitorët në zonën e Kolonjës, guida informuese e Kolonjës me informacion për natyrën , monumentet kulturore dhe natyre , njesitë e shërbimit të zonës, fletëpalosjeve , hartave, banerave, posterave me të dhëna informuese për Kolonjën e cila do të shërbejë rreth 1000 vizitorëve duke sjellë rritjen e të ardhurave në njesitë e shërbimit të hoteleri-turizmit me rreth 30% për vitin 2023,
2. Promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore të folklorit, dhe ruajtjes së traditave të zonës, promovimi i prodhimeve artizanale , gastronomisë etj cka do sjellë zhvillimin e artizanatit dhe rritjen e numrit të vetpunësuarve në këtë fushë e cila do të sjellë shërbim më të mirë të vizitorëve të zonës.

Treguesit e performancës

- ✓ Përmirësimi i klimës vendore për turizëm
- ✓ Përmirësimi i shërbimit në sektorin e turizmit
- ✓ Përmirësimi i shërbimit të promovimit të turizmit me shtesë nr turistësh rreth 1500 , sistem zyre informacioni , nr turistësh që marin informacion rreth 4000
- ✓ nr turistësh që marin informacion

Realizimi i treguesve të performancës / produktet

- ✓ Nr turistësh të akomoduar 28000 nga 22200 të planifikuar
- ✓ Nr turishtësh që marin informacion 4600 .
- ✓ Nr turistësh që vizitojnë muzeun 1000
- ✓ Nr biznesesh me drejtim agrobiznes që mbështeten me subvencionim të sigurimeve shoqërore 10.

Rezultati i pritshëm

- ✓ Krijimi i një infrastrukturë informacioni sa me të plotë dhe të domosdoshëm për vizitorët vendas dhe të huaj që frekuentojne zonën e Kolonjës, shtim nr i bizneseve , rritja ekonomike dhe shtimi i nr të të punësuarve .

Impakti

- ✓ Atraksione turistike lehtësisht të arritshme si dhe turistë më të informuar për zonën e Kolonjës.

- Administrim ,mbikqyrje ,inspektim, organizim dhe mbështetje e sistemit të grumbullimit dhe eliminimit të mbetjeve .
- Mbledhja ,largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake .
- Pastrimi i rrugëve , parqe, lulishte etj.

Qëllimi

- ✓ Të përmirësojë menaxhimin e mbetjeve bashkiake nëpërmjet trajtimit të tyre dhe sensibilizimit të komunitetit lidhur me problematikat që vijnë prej tyre.
- ✓ Të përmirësojë cilësinë e pastrimit të parqeve dhe lulishteve .

Objektivat

1. Ritja e cilësisë së pastrimit nëpërmjet blerjes së paisjeve dhe makinerive që shërbejnë për pastrim gjelbërimin ,dhe si rezultat i shtimit të nr të koshave në vitin 2023 .
2. Të rritet numri i fshatrve që pastrohen me 3 fshatra duke e çuar nga 31 në 34 nr e fshatrave të pastruar , e cila do tu shërbejë rreth 300 banorëve të këtyre fshatrave për vitin 2023 .
3. Të kryhet pastrimi çdo ditë në qytet Ersekë dhe Leskovik dhe 2 herë në javë në fshat .
4. Të krijohen venddepozitime të reja në 5 fshatra dhe rehabilitohen venddepozitimet aktuale në 8 fshatra .

Treguesit e performancës

- ✓ **Mbulimi I të gjithë teritorit të bashkisë me menaxhim të mbetjeve bashkiake**
- ✓ Ritja e mbulimit me shërbime
- ✓ Përmirësimi i cilësisë së shërbimit
- ✓ Ritja e frekuencës së mbledhjes së mbetjeve
- ✓ Norma e mbledhjes së tarifës së shërbimit .
- ✓ Shuma totale e arkëtuar nga tarifa

Realizimi I Treguesve të performancës/ produktet

- Sot pastrohen 34 fshatra në të gjitha njësitë administrative duke shtuar sipërfaqen që mbulohet me shërbim pastrimi , si dhe u caktohen venddepozitimet e mbetjeve për fshatrat që nuk kanë kazane mbeturinash .
- Në 4 fshatra ku kalojnë lumenjtë janë bërë pastrime të mbeturinave dhe inerteve nga punonjësit e sektorit të pastrimit , Barmash ,Gostivisht ,Helmës dhe Shalës
- Janë pastruar dhe mirëmbajtur të gjitha sipërfaqet e lulishteve të dy qyteteve Ersekë dhe Leskovik.

- Janë krijuar 5 venddepozitime të reja në fshatrat e njësive administrative
- Janë mirëmbajtur 11 venddepozitime mbeturinash ekzistuese në fshat
- Largim i Ton / 12 mujor mbeturina 1600 ton /12mujor kundrejt 1600 të planifikuara .
-

Rezultati

Shtohet nr i fshatrave të pastruar i cili sjell dhe shtimin e siperfaqeve të pastruara dhe rrit sasinë e mbetjeve të larguara ,përmirëson kushtet higjeno-sanitare të banoreve,riten të ardhurat e bashkisë Kolonjë.Shtim I hapësirave të gjelbëruara dhe ambjenteve çlodhëse për komunitetin.

Impakti

Jetesë më e mirë ,ambjete më të pastra, dhe me kushtë më të mira për fëmijët ,gratë,të moshuarit.

- Mbrojtja e ajrit dhe e klimës ,mbrojtja e tokës dhe e ujërave nëntokësore
- Planifikimi , administrimi i zhvillimit të teritorit sipas ligjit .

Qëllimi

- ✓ Mbrojtja e ajrit dhe e klimës ,mbrojtja e tokës dhe e ujërave nëntokësore
- ✓ Planifikimi , administrimi i zhvillimit të teritorit sipas ligjit .

Objektivat

1. Zvogëlimi dhe kontrolli ndotjes së mjedisit.
2. Përmirësimi i treguesve të monitorimit të mjedisit : tokë; ajër; ujëra
3. Përmirësimi i mbikëqyrjes dhe inspektimit të veprimtarive që ndosin mjedisn.
4. Shtimi i nr të kontrolleve për ndërtimet pa lejë , dhe kontrollet për lejet e ndërtimit të miratuara me 30 % në cdo vit .

Tregues performance

1. Lirim hapësire publike nr
2. Disiplinimi i mbetjeve inerte m3

Realizimi i treguesve /produktet

1. Nr prishjesh të ndërtimeve 4 ndaj 4 të planifikuara
2. M3 inertesh të disiplinuar 120
3. Kontrolle teritori 80 nga 80 të planifikuara
4. Verifikime dhe zgjidhje konfliktesh 13

Rezultati

Mjedise të pastërta ,të kontrolluara dhe mbajtja nën kontroll e ndërimeve me leje dhe pa leje .

Impakt

Jetë më e sigurt ,më e garantuar dhe më e mirë për të gjitha moshat , fëmijët , gratë dhe të moshuarit .

Programi 06140 Planifikimi Urban

- *Zhvillimin , përditësimin ,bashkërendimin dhe monitorimin e planit të zhvillimit urbanistik lokal.*
- *Lëshimi i lejave për ndërtimet e reja si dhe veprimtari të tjera që ndikojnë në urbanistikën e njësive të vetqeverisjes vendore .*
- *Shpërndarja e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për cështjet e shërbimit dhe të strehimit .*
- *Sigurimi i trualiit të nevojshëm për ndërtime banesash , ndërtim ose blerje dhe rimodelim i njësive banuese për publikun në përgjithësi ose për NJEF me nevoja të posacme .*
- *Eliminimi i ndërtimeve të degraduara e lidhur me sigurimin e strehimit .*
- *Planifikimi i përgjithëshëm duke përfshirë formulimin ,përditësimin ,bashkërendimin dhe monitorimin e planeve të përgjithëshëm vendor dhe planeve të zhvillimit strategjik .*

Qëllimi

- ✓ *Zhvillimi i teritorit të bashkisë në saxe të planifikimit më të mirë të infrastrukturës.*

Objektivat

1. zhvillimin e territorit sipas instrumentave ligjor:

- Plani përgjithshëm vendor
- Planet e detajuara vendore
- Planet sektoriale

2. Planifikimi i mirë i zhvillimit të teritorit **duke rritur të ardhurat e** arkëtuara nga taksa e ndikimit në infrastrukturë me 2000 mijë lekë cdo vit ose legalizimi i rreth 50 shtëpivë në vit.

Treguesit e performancës

1. Nr leje zhvillimi dhe ndërtimi, autorizime dhe deklarata paraprake
2. Aplikimi dhe menaxhimi i projekteve

Realizimi I treguesve /produktet

- ✓ *Leje ndërtimi të miratuara 3*
- ✓ *Deklarata paraprake të miratuara 6 nga 15 të planifikuara*
- ✓ *Hartim I preventivave dhe situacioneve faktike për të gjitha punët dhe shërbimet që kryhen me mjetet dhe punonjësit e bashkisë Kolonjë.*
- ✓ *Shqyrtim ankesash 45*
- ✓ *Leje infrastructure 1 te miratuar nga 5 e planifikuar per 12 mujorin e vitit 2023*
- ✓ *Procedura te nisura per marrjen e pronesise sipas VKM nr 329 nga ASHK 10 te planifikuara per 12 mujorin e vitit 2023 ,10 procedura te realizuara.*

Rezultati

Teritor i bashkisë me zhvillim të qëndrueshëm territorial

Impakti .

Mjedise dhe ambjente të bukura ,clodhëse ,cilësore , siguri në rrugë

06260 Shërbimet publike vendore

Planifikim i përmirësimit dhe zhvillimit të strukturave si

- Rekreacioni ,hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin,
- Mbjellja e luleve,trendafilave dhe pemëve dekorative të cilat shtojnë sipërfaqen e gjelbër.
- Rikonstruksion i trotuareve të prishura me material cilësore që përmirëson hapësirat publike dhe rrit cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve.
- Ndërtimi ,rehabilitim dhe mirëmbajtje e varezave publike dhe deshmorëve të atedheut.
- Parqe ,lulishte dhe hapësirat e gjelbërta publike.

Qëllimi I programit

- ✓ Bashkia siguron zhvillim të planifikuar të komuniteteve të reja dhe atyre ekzistuese.

Objektivat e Programit.

1. Mirembajtja e sipërfaqeve të gjelbërta nëpërmjet mbjelljeve të luleve,trendafilave
2. Përmirësimi i infrastrukturës publike nëpërmjet rikonstruksioneve pjesore në nivel qyteti të trotuareve deri në 1300 m².
3. Të rikonstruktoje 1300 m² trotuare dhe mirëmbajë pjesën e mbetur në qytetin Ersekë për vitin 2023.
4. Të Rehabilitojë dhe mirëmbajë varrezat publike në të gjitha njësitë administrative në vitin 2023 .
5. Të rikonstruktoje 1300 m² trotuare dhe mirëmbajë pjesën e mbetur në qytetin Leskovik për vitin 2023.
6. Shtim hapësirave të gjelbërta në bllokun nr 4 në qytetin Ersekë me 25 m²
7. Rikualifikim i rrugës “Pali Prifti “ Ersekë

Treguesit e performancës

- Ritja e shërbimit për komunitetin
- Përmirësimi I planifikimit të komuniteteve të reja ose të rehabilituara

- Përmirësimi I administrimit të problematikave dhe shërbimeve për zhvillimin e komunitetit , me tregues matës , nr e projekteve për komunitetin , nr i çështjeve të administruara dhe nr i shërbimeve të afuara për zhvillimin e komunitetit

Realizimi i treguesve të performance/ produktet

- Sipërfaqe të gjelbëruara të shtuara 150 m2 nga 150 të planifikuara
- Mirëmbajtje e 21500 m2 sipërfaqe të varezave publike dhe atyre të dëshmorëve .
- Janë mirëmbajtur të gjitha lulishtet e qytetit në një sip 33077 m2
- Mirëmbajtje e 2 objekteve të kultit .
- Janë mbjellë 220 rrënjë pemë

Rezultati

Shtimi sip rekreative krijim i ambjenteve clodhëse dhe argëtuese për komunitetin , trotuare të rikonstruktuar dhe funksionalë për komunitetin .

Impakti

Jetesë më e mirë për komunitetin ,kushte më të mira clodhëse si për fëmijët , gratë, burrat dhe të moshuarit .

- Administrim ,instalimin ,vënien në funksion , mirëmbajtjen ,përmirësimin e cilësisë së ndricimit të rrugëve dhe mjediseve publike.
- Zhvillimi dhe rregullimi i standarteve të ndricimit rrugor .

Qëllimi

- ✓ Të përmirësojë cilësinë e ndricimit të rrugëve dhe mirëmbajë rrjetin e ndricimit ekzistues , të risë nr e fshatravë të ndricuara me rrjetin rrugor në vitet 2021-2023.

Objektivat

1. Të risim sipërfaqen e ndricimit duke shtuar me 34 fshatra të ndricuara në cdo vit buxhetor me ndricim rrugor , e cila do tu shërbejë një popullsie prej rreth 150 banorësh , ose nga 36 fshatra sot do të venë 70 në vitin 2023,
2. Të përmirësojë dhe te mirëmbajë rrjetin e endricimit rrugor , nëpërmjet zëvendësimit të llampave dhe shtimit të kokave të ndricimit , për cdo vit ,duke ritur ndjeshëm cilësinë e ndriçimit.
3. Ndricimi LED I rrugëve të Qytetit Ersekë .

Treguesit e performancës

- ✓ Për përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit.
- ✓ Rritja e mbulimit të territorit me ndricim publik.
- ✓ Përmirësimi I mbulimit të kostove nga tarifat e shërbimit.

Realizimi i tregueve të performancës /produktet

1. Rikonstruksion linjash duke zëvendësuar kabllin e djegur , ndërim koka ndricuesi në 6500 ml nga 6500 ml të planifikuara .

2. Zëvendësim llampash te djeguar në të gjithë teritorin e bashkisë .
3. Rikonstruksion linje tek rruga e kishës .
4. Shtim nr fshatrash të ndricuara 70
5. Eshte shtrirë linjë ndricimi në fshatrat
Boshanj,Helmes,Butke,Shtike,Skorovot,Benjez,Vishanj,Prodan,Lagjia
Kaskollaret,Lagjia e pare dhe e dyte Gjonc,Kamnik,Bogdanas ,Kodras,Kabash,3
lagjet e Msarit.

Rezultati

Cilësi më e mirë në ndricim rrugor , fshatra të rinj të shtuar me ndricim

Impakti

Jetesë me kushte më të mira dhe me një garanci sigurie të shtuar në të gjitha ambientet dhe rrugët e teritorit të bashkisë për të gjitha moshat , fëmijë,të rinj ,gra , burra ,dhe të moshuar

Programi 09120 "Arsimi parashkollor"

09120. Arsimi bazë

Përfshim shpenzimet për paga për mësuesit e kopshteve të femijëve dhe stafit mbështetës.

Programet mësimorë për trajnimin e edukatorëve dhe mësuesve .

Furnizimi dhe mbështetja me ushqim të kopshteve .

Ndërtim dhe mirëmbajtje të strukturave shkollore.

Ndjekja dhe garantimi I aktiviteteve argëtuese dhe promovuese për fëmijet e kopshteve dhe nxënësit e shkollave 9-vjeçare .

Qëllimi

1. Organizimi i aktiviteteve argëtuese ,formuese,evidentimi i talenteve të reja në pikturë-vizatim , sport , muzikë ,letërsisë,i fëmijëve të arsimit parashkollor dhe të arsimit 9- vjecar , me qëllim miqësimin me njeri tjetrin , largimin nga veset e këqia të brezit të ri ,ruajtjen dhe trashëgiminë e traditave kulturore artistike ,me zhvillimin e 10 aktiviteteve me fëmijët e kopshteve në vitin 2023 , 10 aktivitete nga nxënësit e shkollave 9 vjecare.
2. Sigurimi i kushteve optimal të domosdoshme për zhvillimin e procesit mësimor duke u garantuar ngrohjen , kushtet e domosdoshme higjeno-sanitare dhe ato infrastrukturore në vitet 2023-2025
- 3.

Objektivat

1. Organizmi i 20 aktiviteteve me fëmijët e kopshteve dhe nxënësit e shkollave 9-vjecare , me pjesëmarrjen e 178 fëmijëve të 16 kopshteve ,duke promovuar nga 12-20 talente të reja për cdo aktivitet në cdo vit , duke e ritur nr e nxënësve të promovuar sipas talenteve me nga 3-5 nxënës cdo vit , për vitet 2023
2. Sigurimi i kushteve optimal të domosdoshme për zhvillimin e procesit mësimor duke u garantuar ngrohjen , kushtet e domosdoshme higjeno-sanitare dhe ato

infrastrukturore në vitet 2021-2023, për 900 nxënës dhe 119 mësues ,për rreth 19 shkolla dhe kopshte.

3. Dezinfektimi i të gjitha ambjenteve në një sip prej 38634 m2 të shkollave ,kopshteve dhe konviktit Ersekë në varësi të bashkisë Kolonjë.

Treguesit e Performancës

1. Nr shkollash të mirëmbajtura të pastruara, ngrohje dhe të disifektuara
2. Nr aktiviteteve për nx e shkollës 9-vjeçare dhe të kopështit .
3. Ritja e % të regjistrimit të fëmijëve të moshës 3-6 vjeç në arsimin parashkollor
4. Ritja e % të regjistrimit të fëmijëve të moshës 6-14 vjeç në arsimin bazë , minimizimi I braktisjes së shkollës .

Realizimi i treguesve /produktet

1. Janë organizuar nga fëmijët e kopshteve dhe të shkollave 9-vjeçare gjithësej 20 nga 20 të planifikuara aktivitete .
2. Janë mirëmbajtur gjithësej 19 shkolla dhe kopshte në arsimin 9-vjeçar duke krijuar kushte optimal për zhvillimin e mësimin duke garantuar ngrohjen në të gjitha institucionet arsimore .Janë garantuar dhe paguar pagat për të gjithë mësuesit e arsimin parashkollor ,punonjësit e QKF si dhe të atyre ndihmës në arsimin 9-vjeçar.

Rezultati

1. Fëmijë dhe nxënës më të socializuar , më të shkathët , më miqësorë , me promovim talentesh në fusha të ndryshme .
2. Ambjete të pastra ,të mirëmbajtura , të ngrohta , të sigurta për të gjithë stafin mësimor dhe për të gjithë nxënësit duke ritur cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Impakti

Jetesë më e mirë ,kushte më të mira argëtuese dhe mësimore për fëmijët e kopshteve ,nxënësit , dhe mësuesit .

Programi **09230** "*Arsimi I mesëm dhe i përgjithshëm*"

Vështrim i përgjithshëm i programit

1. Ndërtim dhe mirëmbajtje e institucioneve shkollore të arsimin të mesëm të përgjithshëm
2. Shpenzimet për pagat për stafin mbështetës të arsimin parauniversitar
3. Administrim ,ushqim ,strehim dhe dezinfektim dhe kujdes mjekësor për fëmijët që strehoen në konvikt.

Qëllimi

1. Sigurimi i kushteve optimal të domosdoshme për zhvillimin e procesit mësimor duke u garantuar ngrohjen , kushtet e domosdoshme higjieno-sanitare dhe ato infrastrukturore në vitet 2023-2025.

Objektivat

1. Sigurimi i kushteve optimale të domosdoshme për zhvillimin e procesit mësimor duke u garantuar ngrohjen , kushtet e domosdoshme higjeno-sanitare dhe ato infrastrukturore në vitet 2023, për 263 nxënës dhe 21 mësues ,për 3 shkolla të mesme dhe 1 konvikt , dhe mbulimi me paga për stafin mbështetës dhe të konviktit.
2. Sigurimi i kushteve optimal të domosdoshme për zhvillimin e procesit mësimor duke u garantuar ngrohjen , kushtet e domosdoshme higjeno-sanitare dhe ato infrastrukturore për 270 nxënës dhe 21 mësues ,për 3 shkolla të mesme dhe 1 konvikt . dhe mbulimi me paga për stafin mbështetës dhe të konviktit.
3. Rikonstruksioni i tereneve sportive në 3 shkolla të mesme të bashkisë sonë.

Treguesit e Performancës

- Nr shkollash të mirëmbajtura të pastruara, ngrohje dhe të dinstifektuara
- Nr nxënësish dhe mësues në shkollat e mesme
- Ritja e % të regjistrimit të nxënësve që klanë përfunduar arsimin 9-vjeçar në atë të mesëm .
- Ritja e % të regjistrimit të nxënësve në konviktin e shkollës së mesme Ersekë.

Realizmi i treguesve /produktet

- Janë siguruar kushtet optimal të domosdoshme për zhvillimin e procesit mësimor mirëmbajtjen e tyre ,garantuar ngrohjen në 4 institucione arsimore të arsimit të mesëm të përgjithëshëm ose në 3 shkolla të mesme dhe 1 konvikt .
- Janë siguruar materialet e pastrimit për këto shkolla si dhe është bërë disifektimi i tyre një herë në javë .
- Janë krijuar të gjitha kushtet e domosdoshme për nxënësit konviktore ,është sigura ushqimi i tyre , ngrohja , pastrimi për rreth 11 nxënës në fund të 12-mujorit të vitit 2023
- Janë paguar të gjitha pagat e punonjësve mbështetës të arsimit të mesëm të përgjithëshëm dhe të të gjithë punonjësve të konviktit gjithësej 7 punonjës mbështetës dhe 6 punonjës të konviktit .
- Nr nxënësish /mësues 8
- Nr nxënësish / klasë 17

Ambjete të pastra ,të mirëmbajtura , të ngrohta , të sigurta për të gjithë stafin mësimor dhe për të gjithë nxënësit .

Impakti

Cilësi e lartë mësimdhënie ,kushte më të mira higjeno-sanitare,siguri e lartë e jetës së nxënësve dhe mësuesve.

10140: Kujdesi social 10430 Kujdesi Social për familjet dhe fëmijët
10140. Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara

- Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale në nivel vendor për shtresat në nevojë ,personat me aftësi të kufizuar , gra , fëmijë ,gratë e dhunuara , viktimat e trafikimit , jetimët ,nënë apo prindër me shumë fëmijë .
- Në këtë program janë parashikuar pagat e punonjësve të cilët punojnë për shërbimin social në nivel vendor për shtrest në nevojë, personat me aftësi të kufizuara .

Qëllim

- ✓ Sigurimi i fondeve të nevojëshme për pagesat e ndihmës ekonomike dhe personat më aftësi të kufizuar , dhe shpërndarja në kohë e tyre , plotësimi i dokumentacionit të domosdoshëm në kohë të shpejtë dhe me standarte. Zhvillimi dhe hartimi I politikave që ulin nivelin e papunësisë ,përmirësimi I kushteve të jetesës të personave me PAK.

Objektivat

1. Përfshirja në skemë e individëve të përcaktuar me ligj
2. Planifikimi I fondeve të nevojshme për pagesat e ndihmës ekonomike dhe PAK.
3. Krijimi i fondeve për ti ndihmuar financiarisht.
4. Mbrojtja dhe sigurimi i përfituesit nga cdo lloj forme abuzimi
5. Rekrutimi i një stafi të kualifikuar
6. Shpërndarja në kohë paaftësisë dhe invalidët e punës nga bashkia

Tregues performance

- Nr përfituesish të ndihmës ekonomike ndaj familjeve që aplikojnë
- Nr i personave të mbështetur me pagese PAK

Realizimi I treguesve /produktet

1. Numri i personave të mbështetur me pagesë invaliditeti 434 në fund të periudhës.
2. Numur familjesh të mbështetur me ndihmë ekonomike 226 nga sistemi
3. Nr familjesh përfituese të mbështetur me ndihmë ekonomike 6% gjithësej 25 .
4. Persona të mbështetur me pagesë paaftësie 283

Rezultat

Shërbim në kohë dhe cilësor për shtresat në nevojë dhe me aftësi të kufizuara .

Impakt

Rit nivelin e jetesë , me një jetesë me te mirë më të garantuar .

- *Afrimi në para dhe në natyrë për të dhënë mbrojtje shoqërore për familjet dhe fëmijët dhe ndihmë për personat e moshuar ,ndërtimi dhe administrimi i qendrave për afrimin e shërbimeve sociale vendore ,strehë dhe ushqim për fëmijët dhe gratë e dhunuara si strehë afatshkurtër , organizim ,administrim dhe mbështetje të skemave të mbrojtje shoqërore , dhe pagesa e specialistit që mbulon këtë program .*

Qëllimi

- ✓ Bashkia në harmoni me politikën kombëtare zhvillon programe dhe merr masa për minimizimin e rasteve të dhunës .

Objektivat

1. Sistemi i kujdesit social të jetë efikas duke mundësuar të paktën 20 raste të dhunës në familje me paketa ushqimore ,post strehimit të përkohshëm dhe menaxhimit të rasteve .
2. Menaxhimi i ndihmave të mbledhur në mënyrë vullnetare dhe shpërndarja e tyre në familjet në nevojë, për fëmijët jetim ,për gratë e dhunuara dhe për gratë kryefamiljare .
3. Menaxhimi i rasteve të azilkërkuesve të cilët do të strehohen dhe trajtohen tek qendra sociale “ Motrat Qirjazi”

Treguesit e performancë

- Shërbimi i kujdesit social për familjet dhe fëmijët sipas standartit kombëtar
- Mbështetja në para dhe në natyrë për familjet dhe fëmijët në vështirësi social ekonomike.
- Ofrimi i shërbimit optimal për moshat e treta duke u mundësuar falas cdo ditë pirjen e kafes , çait ,një vakt ushqimor si dhe shfrytëzimin e kohës se lirë në mënyrë aktive .

Realizimi I treguesve /produktet

- Nr rastesh gra të dhunuara të trajtuara 7
- Nr fëmijësh të trajtuar 5
- Nr aktiviteteve informuese te ndergjegjesimit ne komunitet per dhunen ne familje,te moshuarit e vetmuar dhe familjet ne nevoje 2

Në bashkëpunim me PNUD janë organizuar takime me komisionet ndërdisiplinare të ngritura për dhunën në familje dhe atë gjinore me pjesëmarrjen e gjithë aktorëve të zgjidhjes së rastit , për trajtimin e këtyre rasteve ,aktivitete ndërgjegjëse me gratë me nxënësit e arsimit 9-vjeçar , po vazhdon puna për këtë çështje .

Rezultati

Uljen e rasteve të dhunës dhe menaxhim i shpejtë i tyre , kushte optimale për shtresat në nevojë.

Impakti

Siguri për jetesë për gratë e dhunuara , ndërgjegjësim ,jetë më e lehtësuar për fëmijët dhe familjet në nevojë,jetesë aktive dhe sociale për moshat e treta.

- **10661 Strehimi social**
Ky program parashikon prfritime në natyrë për të ndihmuar familjet të përballojnë koston e strehimit.Ndërtimi dhe administrimi I banesave për strehim social , sipas mënyrës së përcaktuar në ligj .

Qëllim

- ✓ Përmirësimi i shërbimit të strehimit social nëpërmjet garantimit të pagesës së 90 % të kostos së strehimit për familjet të cilët kanë përfituar statusin e të pastrehëve.

Objektivat

1. Përmirësimi i strehimit dhe komoditeteve të komunitetit, rritja e përfituesve të programeve të strehimit social duke ritur nr e trajtimeve me 25 familje në vitin 2023

Treguesit e performancës

- Nr I familjeve të mbështetura me bonus qeraje .
- Banesa sociale me kosto të ulët

Realizimi I trguesve /produktet

1. Numuri I familjeve që kanë përfituar bonus qiraje për vitin 2023 janë 17 familje përfituese.

Rezultat

Numur i shtuar i familjeve që trajtohen me bonus qiraje .

Impakt

Krijimi kushteve të mira jetese për familjet e pastreha.

08130 Sport dhe argëtim

Vështrim i përgjithshëm i programit

- Programi mbulon operimin ose mbështetjen e strukturave për aktivitete çlodhëse dhe sportive si dhe kontribut financiar për promovimin e sporteve.

08130 Sport dhe argëtim

- Vënie në funksionim ose mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive, aktivitete , krijimin e ambjente te pershtatshme per zhvillimin e veprimtarive sportive (fusha lojërash, korsi vrapimi, etj.), mbështetje për ekipet përfaqësuese vendore (ekipin e te rriturve dhe ekipet zinxhir) ne veprimtaritë sportive

Qëllimi

- ✓ Të nxitë, të zhvillojë dhe të përhapë kulturën sportive nëpërmjet organizimit të projekteve sportive dhe pjesmarrjes në aktivitete te ndryshme si dhe mbeshtetjen
- ✓ ne kampionatin e kategorie se dyte per ekipet e te rriturve dhe ekipet e moshave

Objektivat e Programit

1. Arritja e pozicionit sa më të lartë të Klubit të Futbollit Gramozi ne kategorine e dyte
2. Afrimi i sa me shume fëmijeve në ekipet zinxhir
3. Shtimi i aktiviteteve sportive për ekipet zinxhir
4. Te rritet cilesia e prezantimit te ekipeve të futbollit.
5. Përmirësimi i hapësirave argëtuese dhe sportive

Realizimi I produkteve

1. Nr i ndeshjeve të zhvilluara te ekipit te te rriturve sipas kalendarit sportive te organizuar nga Federata Shqiptare e Futbollit te mbeshtetura me fondet e Bashkise është 40
2. Nr I strukturave per veprimtari sportive 4
3. Nr i ekipeve zinxhir 5 me 55 ndeshje të zhvilluara brenda dhe jashtë rrethit .
4. Nr fëmijësh pjesëmarës në këto ekipe 68.

08220 Eventet artistike dhe kulturore

- *Programi mbulon strukturat kulturore që meren me organizimin dhe mbështetjen e ngjarjeve kulturore , shfaqjeve artistike , prodhime skenike ,dokumentarë dhe koncerte,*
- *sigurimi I shërbimeve kulturore , administrimi I çështjeve kulturore , mbikqyrja dhe rregullimi I strukturave kulturore,*
- *Organizimi _i aktiviteteve kulturore dhe promovim i identitetit kombëtar e lokal*

Qëllim

- ✓ Organizime të aktiviteteve kulturore dhe artistike , duke mundësuar rritjen e jetës kulturore dhe artistike në komunitet .
- ✓ Afrim i publikut drejt aktiviteteve kulturore në fushën e muzikës dhe letërsisë me shtrirje përgjatë gjithë vitit .

Objektivat .

1. Zgjerimi i aktiviteteve dhe rritja e shikueshmërisë me rreth 30% të shfaqjeve artistike dhe të teatrit të kukullave, organizimi i aktiviteteve letrare me nxënës të shkollave 9-vjecare dhe shkollave të mesme të rrethit ne bashkepunim me Qendren Kulturore te Femijeve.
2. Organizimi i 18 aktiviteteve kulturore artistike.
3. Vlerësimi I figurave të shquara që kanë dhënë kontribut në fushën e artit. Organizim dhe mbështetje për ngjarjet kulturore dhe historike

(koncerte, prodhime skenike dhe filma, shfaqje artistike etj.)

Treguesit e performancës

- Ritja e nr të shfaqjeve argëtuese për komunitetin

- Ritja e nr të teatrit të kukullave për fëmijët

Realizimi i tregueve /produktet

1. Nr I shfaqjeve kulturore artistike të mbështetura nga bashkia 18
2. Shfaqje muzikore të realizuara me artistë vendas dhe qendra kulturore 20
3. Premier te teatrit te kukullave ne gjith zonen e Kolonjes nr 2

Rezultati

Aktivitete artistike me cilësi e cila ju shërben grupmoshave te ndryshme , gra, burra, fëmijë të kopshteve dhe nxënësve të shkollave në gjithë zonën e Kolonjës.

Impakti

Ka impakt social kulturor, fëmijë më të gëzuar dhe më të lumtur, largimi i rinisë nga veset e këqija duke i organizuar në aktivitete të ndryshme.

Të dhënat janë të gjitha të analizuara dhe në tabelat bashkalidhur .

ANEKSI 3

Të dhënat e aneksit tre sipas të dhënave në formularin përkatës bashkëngjitur. Në këtë aneks janë të analizuar shpenzimet me nr punonjësish , me artikuj dhe me nënartikujt përkatës ku janë bërë shpenzimet faktike sipas programeve buxhetore .

ANEKSI 4: Të dhënat e aneksit 4-tër sipas formularit përkatës bashkëngjitur , treguesit e performancës të ndara sipas programeve buxhetore .

ANEKSI 5: paraqet projektet e investimeve të realizuar me fondet e brendëshme dhe ato të huaja të listuara sipas objekteve të prokurimit . Shumicën e punëve dhe shërbimeve bashkia e ka përballuar me punonjësit e saj duke kursyer fondet për këto shërbime dhe duke përdorur me efektivitet shpenzimet e këtij institucioni .

DREJTORIA E FINANCËS

Gentjana Duka

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Sofika Rexhepi

